



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SH.A**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra**

**PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER  
KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal eshte per efekt publikimi bashke me dokumentet e tenderit)*

**LLOJI I PROCEDURËS:** *E hapur – me mjete elektronike.*

**OBJEKTI I PROCEDURES:** *“Blerje materiale hidraulike”.*

**KODI PERKATES NE FJALORIN E PERBASHKET TE PROKURIMIT (CPV):** *44115210-4 - Materiale hidraulike.*

**VLERA E FONDIT LIMIT: 10.616.152** *(dhjetë milionë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e dy) Lekë, pa TVSH.*

*(bazuar dhe referuar 3 ofertave të marra nga subjekte tregtare pas studimit të tregut).*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Dibër Sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë;

**I. - 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

**Argumentimi:** *Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe neni 83 “Sigurimi i ofertes”, te ligjit nr.162/2020, “Per Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te nenit 30, pika 1, te VKM-se nr.285, date 19.5.2021, “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik: citojme neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet te kerkoje paraqitjen e sigurimit te ofertes nga ofertuesit ne te gjitha llojet e procedurave te prokurimit, me perjashtim te procedurave te prokurimit me vlere te vogel”, neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.*

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**2.1.1** *Sipas Shtojcës 7, pika 1 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SH.A**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2021, 2022 dhe 2023 nga Operatori Ekonomik, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës që po prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2/b dhe pika 3 të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter, është vendosur bazuar në nenin 43 të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare”, pika 1 citojmë: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndërsa në pikën 2/b citohet: vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, ndërsa në pikën 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar, argumentohet si më poshtë:**

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për të përmbushur me sukses kontratën. Gjithashtu, vendosja e kriterëve në referencë, është kryer që t’i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore, është bërë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 43 pika 1, pika 2/b dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si edhe në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për të përmbushur me sukses kontratën.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që po prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si edhe nenit 40, pika 4 të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SH.A**

Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që po prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme, argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar, është vendosur që t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme, është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme, zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses, sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikatën e cilësisë **SSH/EN-ISO 9001-2015** (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) *ose ekuivalente*; e cila duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe të përfshijë objektin e prokurimit, për rastet kur operatori ekonomik pjesëmarrës është prodhues i mallit. Për rastet kur operatori ekonomik pjesëmarrës nuk është prodhues i mallit duhet të paraqesë një vetëdeklarim në të cilin të deklarojë se furnizuesi është konform standarteve të cilësisë.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikatën e cilësisë **SSH/EN- ISO 1452-1:2009** (Sistemeve të tubacionit me mure të ngurta (PVC-U) të paplastifikuara poly (vinyl chloride) (PVC-U) të destinuar për furnizimin me ujë dhe për kullimin dhe kanalizimet e groposura dhe mbi tokë nën presion) *ose ekuivalente*; e cila duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe të përfshijë objektin e prokurimit, për rastet kur operatori ekonomik pjesëmarrës është prodhues i mallit. Për rastet kur operatori ekonomik pjesëmarrës nuk është prodhues i mallit duhet të paraqesë një vetëdeklarim në të cilin të deklarojë se furnizuesi është konform standarteve të cilësisë.

**Argumentimi:** Kërkesa më sipër është vendosur në mbështetje të nenit 36, pika 3, e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku citohet:

“...3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

*a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

*b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*

*c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SH.A**

*ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”...*

Nëpërmjet kësaj kërkesë Autoriteti Kontraktor kërkon garantimin e një shërbimi të vijueshëm dhe cilësor për realizimin me sukses të kontratës.

**Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.**

*... “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”*

**në mbështetje të nenit 44, pika 1 të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar konkretisht:**

*... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”*

**si edhe në ligjin nr.116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”,** ku përcaktohet se, certifikatat duhet të jenë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që Autoriteti Kontraktor të krijojë sigurinë, që operatorët ekonomikë ofertues, i kanë kapacitetet teknike lidhur me aftësinë e tyre për të realizuar me sukses kontratën. Në lidhje me kërkesën që operatorët ekonomikë ofertues duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin certifikatën e standartit si SSH/EN-ISO (ose ekuivalente), është menduar se, ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit dhe në proporcion me të, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Disponimi i SSH/EN-ISO -s (ose ekuivalente) rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se janë të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizojnë konkurrencën, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet ta paraqesin atë. Paisja me këtë certifikatë SSH/EN-ISO (ose ekuivalente), garanton A.K. që O.E. konkurues, plotësojnë kriteret në funksion të cilësisë së produkteve që tregëtojnë, garanton pajtueshmërinë ligjore dhe përmirësimin e vazhdueshëm.

**2.3.4** Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, ku me anë të cilës të deklarojë se, merr përsipër të kryejë transportin dhe shkarkimin e mallrave të kërkuar në Magazinën të Shoqërisë Rajonale U.K. Dibër Sh.a.; brenda afateve, sasive dhe specifikimeve teknike të përcaktuara.

**Argumentimi:** Vendosja e kriterit të sipërcituar, është vënë në bazë të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të dëshmojnë me anë të deklaratave, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga O.E. dhe dhënia e sigurisë A.K.-së, që kontrata do të realizohet sipas kërkesave të përcaktuara në Dokumentat e Tenderit (D.T.).



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SH.A**

Në bazë të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

**2.3.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet e mëposhtme:

- Kamion 1 (një) me kapacitet mbajtës minimumi 8 (tetë) ton.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Nisur nga sasi të konsiderueshme të mallrave të kërkuar si dhe pesha e tyre është parë e nevojshme të kërkohet ky automjet për transportin e mallrave. Gjithashtu duke qenë se objekt i kësaj kontrate është blerja e materialeve të ndryshme hidraulike, të cilat duhet të furnizohen në sasi dhe cilësi sipas specifikimeve teknike, transporti i këtyre mallrave brenda afatit të parashikuar në D.T. përbën një kusht të domosdoshëm në përmbushjen e objektit të kontratës.

**2.3.6** Operatori ekonomik pjesëmarrës përpara shpalljes fitues me dorëzimin e dokumentacionit provues për kualifikim, duhet të sjellë dhe mostrat e mallrave të kërkuara, për të verifikuar përputhshmërinë e materialeve të kërkuara me specifikimet teknike të përcaktuara.

Këto mostra, operatori ekonomik duhet ti paraqesë në ambientet e Autoritetit Kontraktor Shoqëria Rajonale U.K. Dibër Sh.a., me adresë: Lagjia Minatori, Pallati i Kulturës, Bulqizë sipas Shtojcës nr.6 në Dokumentat e Tenderit (D.T.)

**Argumentimi:** Ky kriter vendoset në mbështetje të gërmës “a” pika 6 e nenit 40 të V.K.M.- së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“...Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit: “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentoj kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose...”*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SH.A**

Njësia e Prokurimit në përcaktimin e këtij kriteri mbështetet në faktin se për të verifikuar përputhshmërinë e materialeve të kërkuara, me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit (D.T.) është e domosdoshme paraqitja e mostrave, për materialet e kërkuara si më sipër.

Mostrat janë kërkuar dhe konsiderohen të nevojshme për tu verifikuar në lidhje me cilësinë e tyre dhe a janë sipas standardit që nevojitet për tu vendosur në rrjetin dhe pajisjet e Ujësjetësve në administrimin e Autoritetit Kontraktor.

Për këtë arsye, referuar llojit dhe funksionit që ato kanë, kërkesa për paraqitjen e këtyre mostrave, vlerësohet e nevojshme dhe e mjaftueshme për realizimin e synimit të Autoritetit Kontraktor duke mos rënduar pozitën ekonomike të operatorëve ekonomik pjesëmarrës.

**II. - Argumentimi i specifikimeve teknike dhe termave të referencës:**

Specifikimet teknike u hartuan nga specialistët e fushës, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e Nenit 36 “Specifikimet teknike” të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, e Nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor për argumentimin e fondit limit, hartimin e preventivit, përcaktimin e specifikimeve teknike, si edhe hartimin dhe argumentimin teknikisht dhe ligjërisht të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, si edhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Në përfundim, duke u bazuar edhe në rekomandimet e lëna nga A.P.P. për këtë lloj procedure prokurimi, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e Dokumenteve të Tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën 12.09.2024, ora 11:30’.

**NJËSIA E PROKURIMIT**